



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 87

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10

Prishtinë, më 24 janar 2014, në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Salihe Mustafa, Nazane Breca, ,Flora Brovina, Gëzim Kelmendi dhe Bahri Thaçi.

Munguan : Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - koordinatorë e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.12.2013**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit**
- 4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2014**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti**
- 6. Të ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Fikrim Damka – Propozoj që pika e 5 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Komisioni njëzëri miratoj rendin e ditës me heqjen e pikës së 5 të rendit të ditës, të propozuar nga kryetari Fikrim Damka .

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.12.2013

Komisioni miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.12.2014.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komision

Fikrim Damka- Koordinatorja e Komisionit ka përgatit raportin e punës së vitit të kaluar, ku janë përfshirë ligjet që kemi pas në shqyrtim e që kanë qenë gjithsej 9 Projektligje , ku 4 prej tyre i kemi përfunduar , 1 është tërheq nga ministria sapo ka përfunduar , dhe 4 të tjera i kemi në procedurë, por mendoj se brenda muajit shkurt do ti përfundojmë . Kemi mbajt 27 mbledhje të komisionit dhe 50 mbledhje të grupeve punuese .

Besoj se ka qenë një vit me punë intensive dhe, edhe pse nuk kemi përfunduar disa Projektligje , kemi punuar shumë sepse kanë qenë shumë ligje të rëndësishme dhe kanë marrë shumë kohë, sidomos Ligji për skemat pensionale dhe Ligji për produktet medicinale. Kemi monitoruar edhe një Ligj dhe kemi pas edhe shumë vizita dhe aktivitete tjera.

Time Kadrijaj – Tha se koordinatorja ka përfshi në raport të gjitha aktivitete e komisionit dhe ne e falënderojmë për punën e bërë , dhe besoj që është pasqyruar puna e komision gjatë vitit 2013. Kemi bërë një punë të përbashkët , në mënyrë që të kemi ligje sa më të mira .

Komisioni pas diskutimeve, njëzëri miratoj raportin e punës së Komisionit për vitin 2013.

4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2014

Fikrim Damka- Tha se duke u bazuar në strategjinë Legjislative të Qeveris për vitin 2014 , dhe Projektligjet që i kemi në procedurë, kemi hartuar planin e punës së Komisionit për vitin 2014.

Këtë vit kemi disa ligje të reja e ndër to Ligjin që e kemi pritur që sa kohë , Ligjin për sigurime shëndetësore. Besoj se në muajin shkurt fillimisht do të fillojmë me këtë ligj dhe të kompletohet edhe Ligji i shëndetësisë .

Na pret një punë intensive deri në korrik , pas korrikut kemi më pak ligje.

Salihe Mustafa – Propozoj që në planin e punës tek vizitat në institucionet shëndetësore të përfshihet vizita në disa qendra emergjente, e sidomos në QKUK. Kjo do të na ndihmonte edhe në amendamentimin e Projektligjit për kujdesin shëndetësor emergjent që do të vjen.

Time Kadrijaj – Propozoj që për Projektligjet që janë në procedurë, të intensifikohet puna dhe sa më shpejt të procedohen , që të fillohet me ligjet tjera.

Sasha Dgjokiq - Tha se pajtohem me planin e punës , por desha ta theksoj që në një mbledhje kam propozuar që të kërkojmë nga ministri i shëndetësisë një informatë lidhur me punësimet në spitalet , në komunat me shumicë serbe dhe nuk kam marr ndonjë përgjigje. Në mbledhjen kur ka qen ministri i shëndetësisë nuk kam marr pjesë por pres të kemi ndonjë përgjigje me shkrim nga ministri apo nga inspektorati shëndetësor. Nuk e di a ka reaguar ministria për këtë çështje.

Fikrim Damak – Në takimin që ka qenë prezent Ministri i shëndetësisë, ne i kemi parashtruar këtë pyetje dhe ai ka thënë se shëndetësia primare është kompetencë e komunave , ndërsa nëse është fjala për shëndetësi sekondare do të kërkojmë informatë nga inspektorati shëndetësor. Deri tani nuk kemi përgjigje me shkrim për këtë çështje.

Sasha Dgjokiq – Tha se kur komuna e Graçanicës është futur në decentralizim , 100 punëtor shëndetësor të punësuar që nga viti 2001 , janë larguar nga puna pa të drejt edhe përkundër që kanë një përvojë të madhe. Ata kanë ngritur edhe një padi. Pres nga ministri një përgjigje se çfarë ka iniciuar lidhur me këta punëtor të larguar nga puna.

Komisioni, pas diskutimeve, njëzëri miratoj planin e punës për vitin 2014.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka